

STATUTI

I

BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Byroja Shqiptare e Sigurimit është person juridik, me seli në Tiranë, e krijuar jo për qëllime fitimi. Veprimtaria dhe funksionimi i saj bazohet në Ligjin nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si edhe në këtë Statut.

PJESA I

TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMËRTIMI DHE SELIA

1.1. "Byroja Shqiptare e Sigurimit", është emërtimi i plotë, ndërsa akronimi i emërtimit është "BSHS".

Në marrëdhëniet e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me Byrotë e tjera Homologe apo Këshillin e Byrove, emërtimi është "Albanian Insurance Bureau" - AL Bureau.

1.2. Selia e BSHS është në Tiranë, në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Edil-Al-It", Kati II-të, Tiranë. Çdo ndryshim i selisë së BSHS, vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe i njoftohet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

1.3. Byroja Shqiptare e Sigurimit ka stemën dhe vulën e saj zyrtare.

1.4. Në të gjitha aktet e dala nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, kundrejt të tretëve, tregohet emërtimi i plotë dhe adresa e selisë së saj.

NENI 2

KOHËZGJATJA DHE USHTRIMI I VEPRIMTARISË

2.1. Byroja ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Statut, për një afat kohor të pacaktuar.

2.2. Periudha e vitit ushtrimor është 12 muaj. Të gjitha transaksionet që i referohen vitit ushtrimor (1 Janar - 31 Dhjetor), që përputhen me vitin financiar të Anëtarëve të Byrosë, do të kontabilizohen brenda këtij viti.

NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

3.1. Objekt i veprimtarisë së BSHS është përmbushja e funksioneve, detyrimeve dhe përgjegjësive brenda kompetencave që derivojnë nga dispozitat e Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe Risigurimit”, Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove dhe këtij Statuti.

3.2. Në ushtrim të kompetencave të saj, Byroja Shqiptare e Sigurimit, kryen funksionet - por pa u kufizuar në to - si :

- përfaqëson shoqëritë anëtare të saj në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në fushën e sigurimit të Kartonit Jeshil apo në fusha tjera që përfshin objektin e veprimtarisë të saj.
- administron Fondin e Kompensimit dhe Fondin e Kartonit Jeshil, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- autorizon lëshimin dhe furnizon Anëtarët e saj me “Çertifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit” (karton jeshil), sipas formatit dhe kushteve të miratuara nga Këshilli i Byrove.
- mbledh, përpunon të dhëna dhe përpilon raporte statistikore dhe analitike në lidhje me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.
- bashkëpunon me Institucionet dhe strukturat e ndryshme shtetërore / publike, për çështje që lidhen me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.
- kryen funksionin e Byrosë Trajtuese dhe garantuese në përmbushje të përgjegjësive dhe të drejtave që lindin nga Rregullorja e Brendshme e Këshillit të Byrove dhe akteve të tjera ndërkombëtare.

NENI 4 ANËTARËSIA

4.1. Anëtar i Byrosë është çdo sigures, i cili është licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e përgjegjësive së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta, nga përdorimi i këtij mjeti dhe/ose në sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik. Siguresi nuk mund të kryejë veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm pa qenë anëtar i Byrosë, siç përcaktohet në nenin 35 të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

4.2. Anëtarësimi në BSHS për çdo anëtar të ri, fillon me hyrjen në fuqi të Vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për dhënien e Licencës për kryerjen e veprimtarisë së siguresit, sipas Ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

4.3. Anëtarësimi në BSHS përfundon me hyrjen në fuqi të vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për tërheqjen/revokimin e Licencës për kryerjen e veprimtarisë së siguruesit, sipas Ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

4.4. Kontributi fillestar i siguruesit për anëtarësim në BSHS, është në shumën prej 2,000,000 (dymilion) leke. Kjo shumë është e detyrueshme për t’u paguar në favor të BSHS-së, përpara sesa siguruesi të bëhet zyrtarisht anëtar i saj. Shuma kalon në buxhetin e BSHS si tarifë anëtarësie.

NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE

5.1. Statusi i anëtarëve është i barabartë në raport me Byronë. Asnjë anëtar nuk mund të shmanget nga detyrimet e këtij statuti dhe as të gëzojë privilegje për shkak të cilësisë së tij ose të pjesës së tij në shpenzimet e BSHS-së, ose për çdo arsye tjetër.

5.2. Anëtar i Byrosë është çdo sigurues i cili është i licensuar për të ushtruar veprimtari sipas përcaktimeve të nenit 35, të Ligjit nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

5.3. Anëtarët duhet të kontribuojnë në përmbushjen e objektit të veprimtarisë së BSHS-së, duke zbatuar parashikimet e legjislacionit përkatës dhe Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

PJESA II ORGANET E BSHS DHE KOMPETENCAT E TYRE

NENI 6 ORGANET DREJTUESE TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Organet drejtuese të Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë :

- Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- Bordi i Drejtorëve;
- Drejtori Ekzekutiv;

NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ANËTARËVE

7.1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës i BSHS.

7.2. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve përbëhet nga përfaqësues të shoqërive të sigurimit, anëtarë të BSHS-së. Çdo shoqëri sigurimi anëtare e BSHS-së, përfaqësohet me një votë në mbledhjet e Asamblesë.

7.3. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve mbledhet në Tiranë, në selinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ose në një vend tjetër ku vlerësohet më i përshtatshëm për ushtrimin e kompetencave të saj.

7.4. Drejtori Ekzekutiv merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve pa të drejtë vote.

7.5. Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, sipas tematikave mund të ftohen për pjesëmarrje ekspertë të ndryshëm, eksperiencia e të cilëve mund të çmohet e nevojshme nga anëtarët e Asamblesë.

NENI 8

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE

Çdo anëtar i Byrosë Shqiptare të Sigurimit merr pjesë në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë nepermjet Drejtorit/Administratorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij. Emri i përfaqësuesit i bëhet i njohur BSHS-së, me anë të një Autorizimi të posaçëm të lëshuar nga Shoqëria Anëtare.

NENI 9

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE

9.1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve ka të drejtën e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet e shtruar në rendin e dites së mbledhjes së saj. Vendimet e Asamblesë hyjnë në fuqi me nënshkrimin e tyre nga anëtarët që përfaqësojnë 50 % + 1 të votave të të gjithë anëtarëve.

9.2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët, pavarësisht nëse e kanë nënshkruar apo jo vendimin përkatës, apo nëse kanë qenë ose jo pjesëmarrës në mbledhjen e Asamblesë, kur janë njoftuar rregullisht sipas këtij Statuti.

9.3. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve ka të drejtën ekskluzive të marrjes së vendimeve - por pa u kufizuar në to - për :

- Emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.
- Zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
- Emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv të BSHS.
- Emërimin dhe shkarkimin e Drejtuesve të Departamenteve/Drejtorive të BSHS dhe Anëtarëve të Komisionit të Dëmeve.
- Miratimin e rregulloreve për veprimtarinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimit;
- Propozimin dhe paraqitjen për miratim në Autoritet të masës së kontributit për Fondin e Kompensimit;
- Propozimin dhe paraqitjen për miratim në Autoritet të buxhetit të BSHS-së, të ndryshimeve të tij, si edhe të raportit vjetor të veprimtarisë së BSHS;
- Përcaktimin e Shoqërisë Audituese për auditimin e pasqyrave financiare;

- Paraqitjen në Autoritet të propozimeve dhe drafteve për përmirësime dhe ndryshime në kuadrin ligjor që normon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.
- Miratimin e pasqyrave financiare të BSHS si dhe ndryshimin e Statutit.
- Propozimin dhe paraqitjen për miratim Autoritetit për rregulloren për administrimin e Fondit të kompensimit.
- Propozimin dhe paraqitjen për miratim Autoritetit rregulloren për administrimin e fondit të garancisë së kartonit jeshil, si dhe rregullat për trajtimin e dëmeve të kartonit jeshil;
- Miraton Strukturën Organizative të Byrosë, numrin e punonjësve si edhe funksionet e detyrat e tyre;
- Autorizimin e ndërhyrjes në vlerën minimale të Fondit të Kompensimit;
- Përcaktimin e kriterëve të tjera për autorizimin e anëtarit për të lëshuar karton jeshil;
- Autorizimin e anëtarit të saj për lëshimin e kartonit jeshil;
- Miratimin e strukturës së auditimit të brendshëm dhe drejtuesin e kësaj njësie;
- Miratimin e pagave, shpërblimeve si dhe trajtimet financiare të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv, Audituesit të Brendshëm dhe punonjësve të tjerë të Byrosë;
- Miratimin e specimeneve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Miratimin e planit vjetor të Auditimit të Brendshëm;
- Të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë statut.

NENI 10

THIRRJA E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE

10.1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve thirret nga kryetari i Asamblesë në sesion të zakonshëm të paktën një herë në tre muaj.

10.2. Anëtarët e BSHS-së, thirren në sesione të zakonshme të mbledhjeve, me njoftim me shkrim të dërguar jo më vonë se 10 ditë para mbledhjes, së bashku me rendin e ditës dhe dokumentacionin përkatës. Në njoftim përcaktohet dita, ora, vendi dhe rendi i ditës së mbledhjes.

10.3. Drejtori Ekzekutiv mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, sa herë që e vlerëson të nevojshme dhe merr pjesë në të gjitha mbledhjet. Të drejtën për të thirrur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve e ka dhe secili anëtar i Asamblesë i cili i paraqet kërkesën për thirrjen e mbledhjes dhe shkaqet e saj. Për këtë i kërkon Drejtorit Ekzekutiv dhe më pas ky i fundit njofton anëtarët.

NENI 11

THIRRJA E MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE

11.1. Kryetari i Asamblesë është i detyruar të thërrasë në sesion të jashtëzakonshëm Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve, me kërkesën me shkrim të disa anëtarëve që përfaqësojnë të paktën 2/5 e numrit të përgjithshëm të votave. Kërkesa me shkrim duhet të përcaktojë edhe pikat e rendit të mbledhjes.

11.2. Mbledhja në kushtet e cituara në pikën 11.1 të këtij neni, thirret brenda 15 ditëve nga data e kërkesës.

NENI 12

ORGANIZIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE

12.1. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm më tepër sesa gjysma e anëtarëve me të drejtë vote. Nëse nuk arrihet kjo pjesëmarrje, atëherë mbledhja mbahet përsëri në të njëjtën ditë dhe orë të javës vijuese, me të njëjtin rend dite dhe pa nevojën e një lajmërimi të ri. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme pavarësisht numrit të pjesëmarrësve.

12.2. Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Asamblesë. Në rast të mungesës së tij, ato drejtohen nga anëtari i caktuar me votim të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

12.3. Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë mbahet nga një punonjës / sekretar i BSHS-së, i caktuar nga Kryetari. Ky procesverbal nënshkruhet nga sekretari dhe kur e kërkon qoftë edhe njëri nga anëtarët e Asamblesë, ai duhet nënshkruar detyrimisht edhe nga këta të fundit.

NENI 13

BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, nga të cilët pesë anëtarë me të drejtë vote, të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve për një periudhë deri në 4 (katër) vjet me të drejtë riemërimi dhe një anëtar pa të drejtë vote të zgjedhur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i Drejtorëve zgjedh kryetarin e Bordit.

Dy prej anëtarëve me të drejtë vote duhet të jenë të pavarur dhe nuk mund të jenë të punësuar në kohë të pjeshme apo të plotë pranë BSHS.

NENI 14

ZGJEDHJA E BORDIT TË DREJTORËVE

14.1. Anëtarët e Bordit të BSHS me të drejtë vote, propozohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton ose refuzon anëtarët e Bordit të Drejtorëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të Vendimit të Asamblesë.

14.2. Anëtarët e bordit të drejtorëve duhet të plotësojnë kërkesat ligjore dhe nënligjore të kualifikimit, përvojës dhe përshtatshmërisë së anëtarëve të drejtorisë së një shoqërie sigurimi sipas Ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", ku ndër të tjera duhet:

- Të ketë diplomë universitare së paku “Master Profesional/DIND”, dhe kualifikime profesionale, të cilat ta kenë aftësuar dhe njohur me fushën e sigurimeve.
- Të ketë përvojë profesionale së paku për 5 (pesë) vite, në një nga fushat që lidhet me : sigurimet, kontabilitetin, jurisprudencën, financën, matematikën, statistikën, aktuaristikën, inxhinierinë, informatikën.
- Të mos ketë qenë ortak apo anëtar i një organi drejtues/ kontrollues/ administrator i një shoqërie, për të cilat janë hapur procedurat e falimentit dhe/ose të një banke/dege të huaj të vendosur në likuidim përgjatë 5 (pesë) viteve të fundit.
- Të mos jetë anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës i një shoqërie sigurimi, përfaqësues, punonjës apo ndërmjetës në sigurime, pranë një Shoqërie apo ish punonjës i një shoqërie sigurimi i larguar për shkelje të konfidencialitetit apo konkurrencës.
- Të mos i jetë refuzuar nga Autoriteti në 12 muajt e fundit kërkesa për t’u bërë anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrjes të një shoqërie, veprimtaria e së cilës është objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale në fushën e krimeve financiare.
- Të ketë integritet, ndershmëri dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të tij;
- Të ruajë pavarësinë, në mënyrë që të mos cënohen interesat e Byrosë nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

14.3. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, si dhe familjarët e tyre nuk mund të jenë palë të lidhura me shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë që auditojnë pasqyrat financiare të BSHS. Për rastet e konfliktit të interesit anëtarët e bordit u nënshtrohen rregullave sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e sigurimit në Shqipëri.

NENI 15

THIRRJA E MBLEDHJES SË BORDIT TË DREJTORËVE

15.1. Bordi i Drejtorëve mbledhet si rregull një herë në muaj. Thirrja e Bordit bëhet nga Drejtori Ekzekutiv i BSHS dhe në raste të veçanta nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Drejtori Ekzekutiv përcakton rendin e mbledhjes dhe përgatit përmes sekretarit të tij, dokumentacionin e nevojshëm i cili vihet në dispozicion, jo më vonë sesa 5 ditë përpara ditës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes.

15.2. Bordi i Drejtorëve mbledhet detyrimisht brenda 10 ditësh nëse kjo kërkohet nga të paktën 3 anëtarë me të drejtë vote. Në kërkesën për mbledhjen e tij, përcaktohet edhe rendi i takimit si edhe dokumentacioni i nevojshëm.

15.3. Drejtori Ekzekutiv i BSHS, merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit.

NENI 16

ORGANIZIMI I MBLEDHJES SË BORDIT TË DREJTORËVE

16.1. Mbledhjet drejtohen nga kryetari i bordit. Në mungesë të tij drejtues caktohet një nga anëtarët i cili zgjidhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezentë.

16.2. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretari i bordit, i cili është një punonjës i BSHS i caktuar nga kryetari. Në përfundim të mbledhjes procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e bordit të pranishëm në mbledhje dhe sekretari.

16.3. Seanca është e vlefshme kur pjesëmarrës janë të paktën 4 anëtarë me të drejtë vote. Kur nuk krijohet ky kuorum, atëherë thirret një mbledhje tjetër. Vendimet e Bordit janë të vlefshme kur është miratuar me shumicën e thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës.

NENI 17 KOMPETENCAT E BORDIT TË DREJTORËVE

17.1. Bordi i Drejtorëve është strukturë kolegjiale dhe vendimmarrëse për çështje që lidhen me administrimin e veprimtarisë së BSHS. Bordi trajton çështje që i ngarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me përjashtim të çështjeve që lidhen me kompetencën ekskluzive të Asamblesë.

17.2. Bordi i Drejtorëve ka kompetencat e mëposhtme :

- Shqyrton dhe propozon para Asamblesë, draft-regulloret e funksionimit të BSHS.
- Shqyrton dhe propozon para Asamblesë projekt-ndryshimet e rregulloreve të funksionimit të BSHS.
- Shqyrton dhe propozon para Asamblesë projekt-ndryshimet e Statutit të BSHS.
- Shqyrton dhe propozon para Asamblesë/Drejtorit Ekzekutiv, nisma dhe politika me synim përmirësimin e veprimtarisë në fushën e sigurimeve.
- Kryhen çdo detyrë tjetër të ngarkuar me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
- Asiston Drejtorin Ekzekutiv për mbarëvajtjen e punës së Byrosë.

17.3. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

NENI 18 DREJTORI EKZEKUTIV

18.1. Drejtori Ekzekutiv i BSHS, zgjidhet dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, pas miratimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë riemërimi. Drejtori Ekzekutiv është Anëtar i Bordit të Drejtorëve të BSHS.

Drejtori Ekzekutiv i BSHS duhet të plotësojë kërkesat ligjore dhe nënligjore të përvojës dhe përshtatshmërisë së anëtarëve të drejtorisë së një shoqërie sigurimi sipas Ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

18.2. Drejtori Ekzekutiv pas emërimit të tij, mund të lirohet nga detyra për arsyet se :

- Jep dorëheqjen;
- Shpallet fajtor për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për një krim në fushën financiare.
- Bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
- Për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës së rëndë që i ka sjellë një dëm Byrosë apo ka cënuar imazhin e saj;

NENI 19

KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV

19.1. Drejtori Ekzekutiv i Byrosë Shqiptare të Sigurimit është i autorizuar të kryejë veprime ligjore për të siguruar aktivitetin e Byrosë si edhe të adaptojë të gjitha masat dhe vendimet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e punës në Byro.

19.2. Drejtori Ekzekutiv drejton veprimtarinë e përditshme të Byrosë në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore përkatëse e veçanërisht ka këto të drejta e detyra :

- Përfaqëson Byronë Shqiptare të Sigurimit në marrëdhënie me të tretët;
- Emëron dhe shkarkon personelin punonjës në përputhje me strukturën e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me përjashtim të Drejtorëve të Departamentit /Drejtorisë;
- Nënshkruan në emër të Byrosë marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurimeve të detyrueshme në sektorin e transportit;
- Deleton shqyrtimin dhe pagesën e një dëmi drejt Anëtarëve të saj ose një strukture të specializuar/korrespondenti, për dëme të shkaktuara në Shqipëri nga automjete me regjistrim të huaj.
- Harton projekt-buxhetin vjetor të Byrosë dhe ja paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;
- Merr masat e duhura dhe ndjek administrimin e shpenzimeve sipas përcaktimeve dhe zërave të buxhetit të byrosë;
- Përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e ushtruar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit;
- Kryen përfaqësim ose lëshon autorizim përfaqësimi në procese gjyqësore ndaj/për Byrosë;
- Mund të delegojë tek punonjës të tjerë të Byrosë, kompetenca ekskluzive të drejtorit ekzekutiv, të caktuara në këtë Statut;
- Merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;
- Drejton strukturën ekzekutive dhe kryen të gjitha detyrat e tjera të ngarkuara me Vendime të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;
- Analizon ecurinë periodike të pagesave dhe të detyrimeve të Fondit të Kompensimit dhe Kartonit Jeshil dhe i raporton Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;

- Me autorizim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve urdhëron prekjen e Garancisë së Kartonit Jeshil;
- Vlerëson rastet e ndërhyrjes në vlerën minimale të Fondit të Kompensimit dhe Kartonit Jeshil dhe ja paraqiet për marrjen e autorizimit Asamblesë së përgjithshme të Anëtarëve.

NENI 20 FORMA E ORGANIZIMIT

20.1. Byroja Shqiptare e Sigurimit organizohet në dy Departamente të pavarura: Departamenti i Kartonit Jeshil dhe Departamenti i Fondit të Kompensimit, drejtorët përkatës së të cilëve janë anëtarë të Bordit të Drejtorëve.

20.2. Departamenti i Kartonit Jeshil, është strukturë e pavarur dhe përbëhet nga Drejtori i Departamentit dhe Specialistët sipas organigramës, që kanë për objekt të tyre ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi që lindin nga anëtarësia në Këshillin e Byrove.

20.3. Departamenti i Fondit të Kompensimit, është strukturë e pavarur dhe përbëhet nga Drejtori i Departamentit dhe Specialistët sipas organigramës.

20.4. Byroja Shqiptare e Sigurimit krahas departamenteve Karton Jeshil dhe Fond Kompensimi, ka në përbërjen e saj dhe disa drejtori, të cilat miratohen me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

20.5. Struktura e Departamenteve/Drejtorive, funksionet dhe detyrat e tyre, propozohen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

NENI 21 FONDI I GARANCISË SË KARTONIT JESHIL

21.1. Fondi i Garancisë së Kartonit Jeshil, krijohet nga Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.

21.2. Çdo anëtar i Byrosë, i autorizuar për të lëshuar karton jeshil, duhet të depozitojë një garanci bankare pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të Byrosë, në shumën që përcaktohet me Vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, por jo më të vogël se 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro.

21.3. Fondi për pagesën e dëmeve të Kartonit Jeshil mbahet në llogari qëllimore të veçantë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve përcakton çdo vit shumën dhe periudhën e depozitimit të këtij fondi.

21.4. Fondi i Garancisë së Kartonit Jeshil, administrohet në një llogari të veçantë qëllimore dhe nuk është objekt i ekzekutimit të asnjë detyrimi që mund të lindë ndaj Byrosë, dhe mund të përdoret vetëm për :

- Rastet e mospërbushjes së detyrimeve financiare të një anëtarit të Byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil.
- Për pagesën e dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një vend anëtar të sistemit të kartonit jeshil, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga mjete motorik i regjistruar në Shqipëri, i pajisur me karton jeshil fals për të cilin Byroja është përgjegjëse sipas rregullave të Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove.
- Në rastin e mbylljes ose falimentit të shoqërisë anëtare të Byrosë.

21.5. Pagesat dhe prekja e Fondit të Garancisë së kartonit jeshil, mund të urdhërohet vetëm nga Drejtori Ekzekutiv i Byrosë, sipas një kërkesë të motivuar të ardhur nga Departamenti i Kartonit Jeshil.

21.6. Për çdo pagesë të kryer nga Fondi i Garancisë Kartonit Jeshil, Byroja njofton Asamblenë e Përgjithshme si dhe shoqërinë e sigurimit për plotësimin e detyrimit të këtij fondi.

NENI 22

FONDI I BYROSË TRAJTUESE SË KARTONIT JESHIL

22.1. Për shkak të përbushjes së detyrimeve të lindura nga Anëtarësia në Këshillin e Byrove, pranë Departamentit të Kartonit Jeshil, krijohet një fond i veçantë në një llogari qëllimore.

22.2. Masa e këtij fondi përcaktohet çdo vit me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

22.3. Fondi i Byrosë Trajtuese së Kartonit Jeshil, përdoret për rastet kur :

- Praktika e dëmit karton jeshil, trajtohet, përfaqësohet dhe paguhet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, në situatën kur nuk delegohet për trajtim/pagesë pranë një Anëtarit.
- Kur nuk pranohet përgjegjësia e shoqërisë/byrosë homologe për dëmin karton jeshil të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Kur përgjegjësia për pagesën e dëmit të rrjedhur nga një automjet me regjistrim të huaj, ndodhet për shqyrtim/mendim/mediation/arbitrazh pranë Këshillit të Byrove.

22.4. Krijimi i këtij Fondi bëhet brenda 6 muajve nga miratimi i këtij Statuti dhe çdo fillim viti plotësohet masa e plotë e tij, me kontribute të përbashkëta të Anëtarëve.

22.5. Pagesa e praktikave përmes këtij fondi bëhet vetëm me Autorizim për Pagesë të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv, Përgjegjësi i Departamentit të Kartonit Jeshil dhe Drejtori i Financës në bazë të një praktike të plotë shkresore shoqëruese, sipas rregullave të Këshillit të Byrove dhe Ligjit Kombëtar.

22.6. Ky fond i veçantë, nuk mund të jetë objekt i detyrimeve të tjera që mund të lindin nga veprimtaria e Byrosë dhe do të përdoret vetëm për rastet e përcaktuara në nenin 22.3 të këtij Statuti.

NENI 23 AUDITUESI I BRENDSHËM

23.1. Audituesi i Brendshëm në BSHS do funksionojë si strukturë e veçantë në varësi të APA-s.

23.2. Plani vjetor i Auditimit të Brendshëm miratohet nga APA dhe Raportet e auditimit i përcillen të gjithë Anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.

23.3. Audituesi Brendshëm kryen këto detyra kryesore :

- Verifikon zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të dhëna strukturave të BSHS nga APA, AMF dhe auditimet e kryera nga Shoqëritë.
- Vlerësimin e veprimtarinë dhe performancën e Departamenteve dhe Drejtorive të BSHS, për realizimin e detyrave funksionale sipas vendimeve të APA dhe Rregullores së Brendshme.
- Vlerësimin për administrimin e Fondit të Kompensimit në zbatim të vendimeve të APA (planifikimi, realizimi, rakordimi midis sektorëve dhe me shoqëritë si dhe saktësinë e raportimit të treguesve të Fondit të Kompensimit).
- Auditimi i praktikave të dëmeve Fond Kompensimi të inicializuara, të paguara dhe praktika pezull, sipas statuseve administrative, gjyqësore dhe Përmbarimore.
- Auditimi i veprimtarisë së Departamentit të Kartonit Jeshil, dëmet MOU, si dhe funksione të tjera që kryen ky departament.
- Auditimi mbi menaxhimin dhe përdorimin e buxhetit të BSHS.
- Auditimi lidhur me administrimin e vlerave monetare dhe materiale të BSHS.
- Auditimi mbi veprimtarinë e Sektorit të Financës (administrimi i vlerave monetare dhe materiale, evidentimi i pagesave si dhe rakordimet mujore me sektoret dhe shoqëritë e sigurimit, etj).
- Verifikimi mbi saktësinë e raportimeve peridike dhe vjetore në APA dhe AMF.
- Auditimi mbi administrimin dhe ndjekjen e Padive të Regresit nga FK.

NENI 24 HYRJA NË FUQI

Ky statut hyn në fuqi me miratimin e tij nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me Vendimin Nr. 15, datë 05.11.2021 dhe Vendimin Nr. 01, datë 06.01.2022.

Miratuar me Vendimin Nr. 04, datë 31.01.2022 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.